



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 147, datë 11.12.2019

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË INTERVISTAVE ME KANDIDATËT E
LEJUAR PËR VENDIN VAKANT TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 229 dhe nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pikës 44 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të intervistave me kandidatët e lejuar, mbi motivimin e kandidimit dhe nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja, për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si më poshtë:

- a) Artur Metani – Data 11.12.2019. Paraqitet në pritje të zhvillimit të intervistës duke filluar nga ora 14.15. Gjuha e huaj: Anglisht
- b) Eris Hysi – Data 11.12.2019. Paraqitet në pritje të zhvillimit të intervistës duke filluar nga ora 15.00. Gjuha e huaj: Anglisht
- c) Joana Asimi Sorraj - Data 11.12.2019. Paraqitet në pritje të zhvillimit të intervistës duke filluar nga ora 15.45.
- ç) Lindita Troja - Data 11.12.2019. Paraqitet në pritje të zhvillimit të intervistës duke filluar nga ora 16.15.
- d) Sokol Stojani - Data 11.12.2019. Paraqitet në pritje të zhvillimit të intervistës duke filluar nga ora 16.45.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI
Ardian DVORANI

